



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:208406
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05403511

E.nr.1124/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditorëve K. dhe N.M., të cilët i përfaqëson av Labinot Buzuku nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Ferizajt, Drejtoria e Arsimit, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën **E.nr.1124/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1124/23, të datës 03.08.2023, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit aktgjykimit 2022:208407, të datës 03.03.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimet e datës 17.10.2023 dhe 04.03.2024, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit, ta transferoj shumën e mjeteve prej 5,387.44 euro dhe 446.53 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1124/23, më datë 04.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi